



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 813 Prot.

Tiranë, më 04. 06. 2018

V E N D I M

Nr. 133, Datë 04. 06. 2018

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 4, datë 11.01.2018, e shtetasit E. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë (në vijim IEVP Vlorë), në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të gjendjes ekonomike dhe shoqërore*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas pretendimeve të paraqitura në ankesë, E. D. ka filluar punë pranë IEVP-së Vlorë, në pozicionin Punonjës i Rolit Bazë, i Policisë së Burgjeve, me gradën N/Inspektor. Në datën 21.04.2017, është planizuar për të qënë në shërbim, turni i dytë, në godinën A, kati i II-të, në kollon. Rreth orës 19:00 të kësaj date, si rezultat i rebelimit, disa të paraburgosur kanë ndezur një zjarr në ambientet e brendshme të paraburgimit. Situata është tensionuar duke nisur një konfrontim fizik për t'i marrë çelësin e kasetës së kollonës, mes 4 (katër) personave të paraburgosur dhe ankuesit. I ndodhur i vetëm në këtë situatë, ankuesi është detyruar të hedh çelësin nga dritarja e godinës dhe të kërkojë ndihmë nga strukturat e IEVP-së Vlorë. Shefi i Policisë dhe Drejtori i IEVP-së Vlorë, pasi kanë analizuar ngjarjen e ndodhur, kanë nisur procedimin disiplinor dhe kanë dhënë masën “Vërejtje me paralajmërim”, vetëm ndaj ankuesit dhe katër punonjësve të tjerë. Sipas E. D., Grupi i Sigurisë së IEVP-së Vlorë edhe pse ka përgjegjësinë kryesore për të ndërhyrë në situata të tilla nuk është ndëshkuar me masë. Lidhjet familjare dhe shoqërore që punonjësit e

Grupit të Sigurisë, kanë pasur me ish Drejtorin e IEVP-së Vlorë, B. B., ka sjellë mos ndëshkimin e tyre. Nëpërmjet shkresës nr. 681 prot., datë 02.05.2017, nga ana e drejtuesve të IEVP-së Vlorë, i është propozuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve masa disiplinore “Largim nga detyra”. Më datë 04.05.2017, me shkresën nr. 3754/1 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka urdhëruar largimin nga detyra të N/Inspektorit E. D., me detyrë punonjës i rolit bazë pranë Drejtorisë së IEVP-së Vlorë, me motivacionin “*Shkelje të rënda të rregullave të shërbimit me pasojë ngjarjen e ndodhur në IEVP Vlorë*”. Për ankuesin dhe një punonjës, Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore pranë Ministrisë së Drejtësisë, ka vendosur rishikimin e urdhërit për largimin nga puna, ndërsa për tre punonjësit e tjerë është lënë në fuqi urdhëri i largimit nga puna. Më datë 25.10.2017, ankuesi është vënë në dijeni se kolegu i tij, për të cilin Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore kishte vendosur rishikimin e urdhërit të largimit nga puna, është rikthyer në punë. Në këto kushte, ka kërkuar të takohet me drejtuesit e IEVP-së Vlorë dhe për të marrë dijeni mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore, por nuk është lejuar të hyjë në ambientet e këtij institucioni. I ndodhur në këtë situatë, ankuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila ka vendosur: “*Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë, t’i paguajë paditësit E. D. si dëmshpërblim, pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve, për shkak të largimit nga detyra si punonjës i Policisë së Burgjeve pranë IEVP Vlorë në mënyrë të paligjshme*”. Sipas ankuesit, trajtimi në mënyrë të diferencuar lidhet dhe me faktin se në vendin e punës që ai mbante është emëruar një person tjetër, i cili nuk plotëson kualifikimet dhe kriteret e arsimore të nevojshme.

Përsa më lart, ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë, gjatë procedurave të largimit nga puna dhe mos rikthimit, për shkak të gjendjes shoqërore¹ dhe arsimore².

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

¹ Për shkak se ankuesi nuk kishte lidhje familjare dhe marrëdhënie shoqërore me drejtuesit e IEVP-së Vlorë, është larguar nga puna

² Për shkak se në pozicionin që ai mbante është emëruar një punonjës tjetër, i cili nuk plotëson kualifikimet dhe arsimin e nevojshëm.

1. Mbështetur në nenin 33, pika 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pas verifikimit paraprak të ankesës, inspektori i çështjes mori takim me subjektin ankues dhe i kërkoi informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë.
 - Gjatë takimit më datë 18.01.2018, subjekti ankues sqaroi se: *“Së pari, pas konfliktit të ndodhur në ambientet e IEVP-së Vlorë, vetëm ndaj 5 individëve është marrë masë disiplinore për largim nga puna, ndërsa ndaj punonjësve të sigurisë nuk është marrë asnjë masë, pasi një prej tyre është vëllai i ish-Drejtorit të IEVP-së B. B. Grupi i Sigurisë ishte përgjegjës për neutralizimin e të paraburgosurve dhe për asnjë prej tyre nuk është marrë masë largimi, pasi kishin lidhje familjare me B. B., si p.sh. punonjësi i Grupit të Sigurisë, S. B., vëllai i B. B. Së dyti, pjesa tjetër e ankesës lidhet me mos rikthimin e ankuesit në pozicionin e mëparshëm të punës dhe rikthimin e shtetasit I. S., i larguar nga puna me të njëjtin motivacion. Për shkak të shoqërisë që ka patur me B. B., ish drejtorin e komanduar A. RR. dhe me shefin e Burimeve Njerëzore F. A., I. S. është rikthyer në punë ndërsa unë si ankues jo. Së fundmi, fakti që kam cituar si shkak diskriminimi gjendjen ekonomike dhe shtatëzaninë e bashkëshortes në ankesë, lidhet e arsyen për përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës.”*
2. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 25/1 prot., datë 31.01.2018, kërkoi informacion lidhur me pretendimet e subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë.
 - Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me anë të shkresës³ nr. 1202/1 prot., datë 09.02.2018, sqaroi se: *“Bazuar në informacionin e Drejtorisë së Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, N/Inspektor E. D., me detyrë Përgjegjës Kollone në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, ndodhej me shërbim në godinën A, kati III. Në momentin e ndodhjes së ngjarjes së rëndë në IEVP Vlorë, E. D. ka braktisur detyrën dhe është larguar, ndërsa punonjësi i rolit bazë Inspektor I. S. ka qëndruar në detyrë.”*
 - Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimit Penal Vlorë, me anë të shkresës⁴ nr. 195 prot., datë 08.02.2018, sqaroi se: *“Institucioni i IEVP-së Vlorë, pasi ka analizuar ngjarjen e 21. 04. 2017, dhe për këtë ish punonjës të policisë, është bërë një shkresë e brendshme (informacion), drejtuar drejtorit të institucionit me nr. extra, datë 21.04.2017, me lëndë “Propozim për procedim disiplinor të p.r.b. E. D.”. Në këtë shkresë renditen të gjitha shkeljet disiplinore që janë bërë nga ky punonjës në datën 21.04.2017, në të cilën citohet se nuk ka menaxhuar situatën sipas rregullave, ka lejuar të p/burgosurit të*

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 25/3 prot., datë 14.02.2018

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 25/2 prot., datë 12.02.2018

marrin në kontroll katin e tretë të godinës A, duke lënë vendshërbimin. Këto veprime, parashikohen në urdhërin nr. 150, datë 26.05.2015, mbi zbatimin e përshkrimin e detyrave të policisë së burgjeve sipas vendshërbimeve dhe më konkretisht në nenin 26 të kësaj rregulloreje përshkruhen detyrat e punonjësit të rolit bazë, si dhe në pikën 2 të këtij neni thuhet se: në tre turnet marrja në dorëzim e shërbimit, kryhet nga ana e dy p.r.b. (marrësi dhe dorëzuesi) në kollon, sipas inventarit të elementëve të sigurisë etj. Pra, ky punonjës policie nuk ka ngritur pretendimin mbi elementët e sigurisë, pasi kur ka marrë në dorëzim turnin, ka firmosur duke u shprehur se janë në rregull. Nga të gjitha parashtrimet e mësipërme, shtetasi E. D. nuk ka kryer asnjë nga këto detyra të parashikuara në rregullore. Në propozimin për shkelje që ky punonjës policie ka bërë gjatë kryerjes së shërbimit datë 21.04.2017, është evidentuar sjellja e tij sipas kësaj shkrese, që bie ndesh me “Përshkrimin e detyrave të policisë së burgjeve” nr. 150/1, datë 26.05.2015 detyrat e p.r.b. në kollonë gjithashtu sipas rregullores nr. 5251/2, datë 30.07.2010 “Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të policisë së burgjeve”. Ky punonjës policie ka kryer veprime që bien ndesh me uniformën që mban, si dhe ka manifestuar një sjellje aspak profesionale në raport me detyrën funksionale që ka. Nga ana e komisionit janë marrë masat për fillimin e procedurave disiplinore dhe është bërë njoftimi i këtij punonjësi më datë 25.04.2017. Punonjësi i Policisë është njohur me urdhërin e ngritjes së këtij komisioni në këtë datë dhe arsyen përse ky komision është mbledhur. Është zhvilluar në këtë datë seanca e dëgjimit të palëve në këtë komision, ku ka qënë i pranishëm edhe vetë punonjësi E. D. Komisioni pasi ka dëgjuar palët dhe ka marrë sqarimet e nevojshme për shkeljet disiplinore të kryera, ka vendosur që shkelja e kryer nga punonjësi i policisë ka qënë e natyrës së rëndë disiplinore, përkatësisht “Shkelje e rregullave të shërbimit dhe detyrave” dhe për këtë arsye duhet ti drejtohet D.P. Burgjeve me propozim për largim nga detyra të punonjësit të rolit bazë E. D., duke qënë se natyra e masës ka qënë e tillë, që duhej të delegohej për shqyrtim të mëtejshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ky propozim me nr. 684 prot., datë 28.04.2017, është dërguar në DPB bashkë me praktikën bashkëngjitur. Propozimi dhe praktika e ndjekur nga institucioni i IEVP Vlorë, pasi është depozituar në DPB është vlerësuar e rregullt dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Burgjeve është bërë propozimi për largimin nga detyra të N/Inspektor E. D., me detyrë punonjës i rolit bazë, me motivacionin “Shkelje e rëndë e rregullave të shërbimit me pasojë ngjarjen në IEVP Vlorë”. Në bazë të këtij propozimi ka dalë edhe urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me nr. 3754/1, datë 04.05.2017, ku urdhëron largimin nga detyra të N/Inspektor E. D., me detyrë p.r.b., me motivacionin “Shkelje të rënda të rregullave të shërbimit me pasojë ngjarjen në IEVP Vlorë”. Gjithashtu shtetasi E. D. ka ngritur padi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për këtë shkak IEVP Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është në një proces gjyqësor, dhe në asnjë moment shtetasi E. D. në kërkesë-padinë e ngritur nuk shprehet për diskriminimin e bërë kundër tij.”

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, IEVP Vlorë vuri në dispozicion të KMD-së shkresat e mëposhtme:

- Kopje e Plan-Kontrollit për elementët e sigurisë Nr. 633 prot., datë 21.04.2017, si dhe bashkëngjitur procesverabli i konkluzioneve të kontrollit.
- Proceverbalin e takimit të mbajtur me ankuesin lidhur me ngjarjen e ndodhur.
- Kopje e Librit të Procesverbaleve të Marrjes dhe Dorëzimit të Shërbimit në Rregjimin e Brendshëm Kollon-Sektor
- Kopje të Librit të Aktivitetit 24 orësh .
- Kopje e shkresës “Analizë për shkelljen disiplinore dhe propozim” për dhënien e masës disiplinore ndaj shtetasit E. D.
- Kopje e Planizimit të Shërbimit Rregjimi i Brendshëm datë 21.04.2017
- Kopje e informacionit mbi gjendjen e elementëve të sigurisë në IEVP Vlorë, datë 21.04.2017.
- Kopje e Urdhërit për largimin nga detyra të shtetasit E. D.

3. Mbështetur në Urdhërin nr. 45, datë 23.02.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë IEVP-së Vlorë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e E. D.”, më datë 08.03.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë IEVP-së Vlorë, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë IEVP-së Vlorë, u mor takim me Drejtorin e këtij institucioni, I. A., i cili informoi lidhur me çështjen se: *“Lidhur me ngjarjen e ndodhur më datë 21.04.2017, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga ana jonë, janë marrë masat për largimin nga puna për 5 punonjës, përkatësisht për shtetasit: I. S., E. D., O. B., P. K. dhe S. K. Pas shqyrtimit nga Komisioni për Ecurinë Disiplinore në IEVP Vlorë, për 5 punonjësit u propozua masa disiplinore për largim nga detyra. Pasi u shqyrtuan masat e propozuara nga IEVP Vlorë, Komisioni i Apelit në Ministrinë e Drejtësisë, ka vendosur rishikimin e masës disiplinore për largimin nga puna për punonjësit: E. D. dhe O. B. Si autoriteti përgjegjës për emërimet dhe largimet nga detyra të punonjësve të burgjeve, DPB ka rikthyer në detyrë vetëm punonjësin I. S. Lidhur me rishikimin e vendimit për largimin nga puna të E. D. dhe O. B., IEVP Vlorë nuk ka kompetencë”.*

4. Në vijim të trajtimit të ankesës së E. D., më datë 04.04.2018, pranë Zyrës së KMD-së, u realizua seanca dëgjimore, ku morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe pala ankuese.

Fillimisht nga ana e përfaqësuesve të DPB, u sqarua se: *“...për situatën e ndodhur në IEVP Vlorë janë marrë masa për largimin nga puna për 5 (pesë) punonjës, ndër ta edhe për ankuesin. Sipas legjislacionit, në DPB ekziston një komision ankimimi i masave disiplinore, si dhe në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur një Komision i Apelit të Masave Disiplinore. Fillimisht procedura*

kërkon që masat disiplinore të ankimohen në komisionin e DPB e më pas në komisionin e ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ankuesi nuk e ka ndjekur këtë rrugë dhe ka ankimuar masën pranë Ministrisë së Drejtësisë. Sipas informacionit, pas kqyrjes së vendimit për rikthimin në punë dhe pas informacionit të marrë nga drejtuesit e IEVP-së Vlorë, nga DPB është vendosur për mos rikthimin në detyrë të E. D. Mbështetur në detyrat e Përgjegjësit të Kolonës, ky i fundit ka përgjegjësinë kryesore dhe administron çelësat e gjithë katit të godinës. Fillimisht kalohet në kolonë e më pas shkohet drejtë sektorit ku kryente shërbimin punonjësi i rikthyer, I. S. Grupi i sigurisë së IEVP-së, ka neglizhuar fillimisht situatën dhe të paraburgosurit kanë shfrytëzuar situatën dhe kanë arritur të largohen në katin e III-të të godinës A. Ankuesi është larguar pasi ka hapur derën e kollonës, këto janë të vërtetuara edhe nga pamjet filmike. Çelësat e dhomave i administron Përgjegjësi i Kolonës dhe pa kaluar nga kolona asnjë nga të paraburgosurit nuk mund të kalojë në sektor.”

Në vijim të pretendimeve të ngritura në ankesë, gjatë seancës dëgjimore sqaroi se: “Shkaku i diskriminimit lidhet me gjendjen ekonomike, pasi I. S. (i cili është rikthyer në detyrë) ka gjendje ekonomike më të mirë se unë, si dhe me shkakun e gjendjes shoqërore pasi I. S. ka patur njohje me drejtuesin e IEVP-së dhe kjo është arsyeja e rikthimit të tij në detyrë.”

Duke qënë se Institucioni i Ekzekutimit të Vendimit Penal Vlorë, nuk u paraqit në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 04.04.2018, me anë të shkresës⁵ Nr. 590 prot., datë 18.04.2018, ndër të tjera informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi se: “...personat që janë ngarkuar me përgjegjësi për ngjarjen e datës 21.04.2017, janë punonjësit I. S., O. B., P. K., S. K. dhe E. D. Ne si institucion nuk mund t’i propozojmë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që të rishikojë edhe një herë vendimet e saj, referuar propozimeve të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore të Ministrisë së Drejtësisë. Punonjësi I. S. nuk është rikthyer në detyrë me propozim të IEVP-së Vlorë, por me vendim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.”

Në mbështetje të pretendimeve të sipërcituara, IEVP Vlorë, vuri në dispozicion të gjithë procedurën e ndjekur për punonjësit I. S. dhe E. D.

5. Pas informacionit të administruar ngjatë seancës dëgjimore të datës 04.04.2018, nëpërmjet shkresës Nr. 542 prot., datë 19.04.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërish Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke i kërkuar të vërë në dispozicion informacion shtesë dhe kopje të parashikimeve ligjore, lidhur me detyrat e Përgjegjësit të Kolonës në Burgje.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 456/1 prot., datë 20.04.2018.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, vuri në dispozicion⁶ sërish të njëjtin informacion të dhënë në shkresën Nr. 1202/1 prot., datë 09.02.2018 dhe asnjë dokumentacion shtesë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara nga të dy palët, rezultoi se:

I. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, ankuesi ka filluar punë pranë IEVP-së Vlorë, në pozicionin Punonjës i Rolit Bazë, i Policisë së Burgjeve, me gradën N/Inspektor, më datë 18.04.2014. Në datën 21.04.2017, ai dhe shtetasi I. S. janë planizuar për të qënë në shërbim, turni i dytë, në katin e III-të, të godinës A. Referuar *procesverbalit të marrjes dhe dorëzimit të shërbimit në rregjimin e brendshëm kollon-sektor*, të IEVP-së Vlorë, evidentohet se pasi kanë marrë turnin e II-të të shërbimit, E. D. ka firmosur *marrjen në dorëzim të turnit duke u shprehur se elementët e sigurisë janë në rregull*. Ankuesi ka mbajtur detyrën e Përgjegjës të kollonës, ndërsa punonjësi I. S., detyrën e Përgjegjës të Sektorit. Rreth orës 19:00 të kësaj date, si rezultat i rebelimit, disa të paraburgosur kanë nderur një zjarrë në ambjentet e brendshme të katit të parë të paraburgimit dhe janë drejtuar për në katet më lart të godinës. Gjatë momentit që nga ana e E. D., po kontrollohej i paraburgosuri që do të shërbente ushqimin, në katin e III-të të godinës janë shfaqur 4 (katër) të paraburgosurit e irrituar. Situata është tensionuar duke nisur një konfrontim fizik midis tyre dhe ankuesit. Në këtë moment, të paraburgosurit kanë arritur të hyjnë në sektor dhe kanë nderur sërish zjarrë, duke krijuar një ambjent që përbënte rrezik për jetën e të paraburgosurve dhe punonjësve të IEVP-së. I ndodhur në këtë situatë, ankuesi ka hedhur çelësin e kasetës së kollonës nga dritarja e godinës dhe është larguar nga vendshërbimi, duke lënë kolegun e tij shtetasin I. S. të konfrontohej me të paraburgosurit. Sipas informacionit të administruar dhe referuar detyrave funksionale të pozicionit “*Përgjegjës kollone*”, ky i fundit është personi i ngarkuar me përgjegjësi për administrimin e çelësave të të gjithë katit dhe jo vetëm të kolonës. Në këto kushte, evidentohet fakti se ankuesi është personi i cili mbante përgjegjësinë e administrimit të çelësave të katit të III-të të Godinës A, ditën që është zhvilluar ngjarja.

Pika d) e nenit 38, të Ligjit Nr. 10 032, datë 11.12.2008 “*Për policinë e burgjeve*” të ndryshuar, parashikon se: “*Autoritetet për dhënien e masës disiplinore janë: Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve*

⁶ Me anë të shkresës Nr. 3989/1, datë 23.04.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 542/1 prot., datë 24.04.2018.

kryesisht ose në bazë të propozimit të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm, për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”.

Përsa më lart dhe pasi është analizuar ngjarja e ndodhur, nga ana e Drejtorisë së IEVP-së Vlorë, i është propozuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve masa disiplinore “Largim nga detyra”, për 5 (pesë) punonjës të IEVP-së. Më datë 04.05.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka urdhëruar largimin nga detyra të I. S., O. B., P. K., S. K. dhe E. D., me detyrë punonjës të rolit bazë pranë Drejtorisë së IEVP-së Vlorë, me motivacionin “*Shkelje të rënda të rregullave të shërbimit me pasojë ngjarjen e ndodhur në IEVP Vlorë*”.

Në pikën 1 dhe 2 të nenit nr. 40 të Ligjit Nr. 10 032, datë 11.12.2008 “*Për policinë e burgjeve*” të ndryshuar, citohet se: “*1. Komisioni i apelimit të masave disiplinore krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë. 2. Komisioni i Apelimit të masave disiplinore ka kompetencë për të lënë në fuqi masën disiplinore, kur e gjen të bazuar, ose propozon rishikimin e saj nga autoriteti që ka dhënë masën...*”.

Gjithashtu, Urdhëri Nr.3125/1, datë 04.09.2009 i Ministrisë së Drejtësisë, “*Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve*”, në pikën 1, të nenit 65 parashikon: “*Punonjësi i policisë ndaj të cilit merret masë disiplinore “Pezullim pa të drejtë page nga një deri në tre muaj”, “Ulje në gradë ose në funksion”, “Largim nga detyra”, ka të drejtë të paraqesë ankim me shkrim për masën e dhënë te Komisioni i Apelimit të Masave Disiplinore në Ministrinë e Drejtësisë, së bashku me kopjet e akteve shkresore me të cilat ankuesi provon pretendimin e tij, brenda 10 ditëve pune nga çasti i marrjes dijeni me shkrim për dhënien e asaj mase.”*

Përsa më lart, shtetasit O. B., P. K., S. K. dhe E. D., kanë ankimuar vendimin në Komisionin e Apelimit të Masave Disiplinore pranë Ministrisë së Drejtësisë, i cili ka vendosur rishikimin e urdhërit për largimin nga puna, vetëm për shtetasit O. B. dhe E. D., ndërsa për dy punonjësit e tjerë është lënë në fuqi urdhëri i largimit nga puna. Ndërsa, I. S., ka kërkuar rishikimin e vendimit të largimit nga puna tek Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, i cili në përfundim ka vendosur rikthimin në detyrën e mëparshme.

Neni 7, pika 1, e ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*” parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të*

njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në përfundim, Komisioneri konstaton se, referuar vendimeve të marra nga ana e Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore pranë Ministrisë së Drejtësisë, për rishikimin e urdhërit për largimin nga puna, të ankuesit dhe O. B., asnjë prej tyre nuk është rikthyer në punë. Ndërsa, me vendim të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është rikthyer vetëm I. S.

Në këto kushte, evidentohet se gjatë procedurave të largimit nga puna të 5 (pesë) punonjësve dhe propozimit nga ana e IEVP-së Vlorë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka trajtuar në të njëjtën mënyrë të gjithë këta punonjës, duke marrë vendimin për largimin nga puna. Gjithashtu, po në të njëjtën mënyrë ka trajtuar dy punonjësit për të cilët Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore në Ministrinë së Drejtësisë kishte vendosur rishikimin e masës disiplinore të largimit nga puna.

Në analizë të provave dhe informacionit të sipërcituar, Komisioneri evidenton se E. D. nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë, në raport me shtetasin I. S., lidhur në procedurat e ndjekura për rikthimin në detyrë.

II. Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar për shkak të kundërshtimeve ndaj eprorëve.

Mbështetur në nenin⁷ 2 të ligjit nr. 10221, datë 02.04.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

⁷ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e IEVP-së Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës dhe shpjegimet e dhëna nga palët, nuk provohet fakti që ka patur një trajtim të diferencuar dhe të pabarabartë gjatë procedurave të largimit dhe emërimit në punë, të ankuesit krahasuar me të tjerë, si dhe me shtetasin I. S., për shkaqet e pretenduara. Fakti që ankuesi pretendon se shkakun i gjendjes ekonomike, ka bërë që të trajtohet në mënyrë diskriminuese krahasuar me shtetasin I. S., nuk është i mbështetur në prova dhe në fakte.

Gjithashtu vlen të theksohet fakti se, drejtuesi i IEVP-së Vlorë ka propozuar largimin nga puna për I. S. dhe 4 (katër) punonjësve e tjerë të IEVP-së Vlorë. Ndërsa, rikthimi në detyrë i I. S. është bërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe jo nga drejtuesit e IEVP-së Vlorë. Në këto kushte, nuk provohet trajtimi i diferencuar dhe i pabarabartë gjatë procedurave të emërimit në punë, të ankuesit krahasuar me shtetasin I. S., për shkak të lidhjeve shoqërore që ky i fundit pretendohet të kishte me drejtuesit e IEVP-së Vlorë.

Referuar fakteve dhe provave të sipërcituara, nuk konstatohet të jenë përdorur praktika diskriminuese ndaj E. D., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi, pasi nuk rezultoi të ekzistonte një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkakut të pretenduar.

⁸ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në përfundim, Komisioneri nuk arriti të administrojë prova për të vërtetuar që, trajtimi i pabarabartë i ankuesit dhe paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë, të lidhen me shkakun për diskriminim, të pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/a), b), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. D., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP-së Vlorë, për shkak të gjendjes ekonomike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja ekonomike)

(Fusha: Punësim)